

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Inside Story/ A janë gjyqtarët në konflikt interesi me hetimet dhe vendimet për pagat?! Juristët: E qartë që e bëjnë edhe për vete...
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/23/inside-story-a-jane-gjyqtaret-ne-konflikt-interesi-me-hetimet-dhe-vendimet-per-pagat-juristet-e-qarte-qe-e-bejne-edhe-per-vete/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:27:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	23 shtator 2026, 19:23:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 23 shtator 2026, 19:22:00 UTC → 23 shtator 2026, 19:24:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9bff1bdac76d1dc789ab4ea4a9764398aa239dc95b95813919ce5fb5df3e1da6
TEKSTI	81fb7e378574683f272ae612f4c63a66d5f933270a7e4ba72b2e8b8a675f96ab
PAMJA	7f0469d8b83ac13a4eb117affb1ae1f3e357d0234a418e05fcf62e5dab2f9f2d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bdad2f69f31afc268e604fcca13eb98d8365c9401449b2f1b125ed5a3f267195
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bdad2f69f31afc268e604fcca13eb98d8365c9401449b2f1b125ed5a3f267195>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

INSIDE STORY **TË FUNDIT**

Inside Story/ A janë gjyqtarët në konflikt interesi me hetimet dhe vendimet për pagat?! Juristët: E qartë që e bëjnë edhe për vete...

23/09/2026 21:23



Nën sfondin e një reforme mjaft të debatueshme, sot debati publik është fokusuar tek hallet e vetë sistemit, pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ligji i vitit 2016 e ndërtoi pagën bruto nga paga referuese bazë dhe shtesat për grupin, vjetërsinë, drejtimin dhe vështirësinë. Baza u lidh me "pagën për funksion" të drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, ndaj çdo ndryshim i referencës në administratë ndikonte automatikisht te magjistratët. Skema nisi të zbatohet pas 1 janarit 2019.

"Ose ka ndryshuar në mënyrë të qëllimshme, ose ka ndryshuar për shkak të padijenisë, për shkak të mungesës së përfytyrimit mbi pavarësinë e gjyqësorit. Në 2016-n e lidhi fillimisht me pagat referuese në administratën publike, sekretari i përgjithshëm, drejtori i përgjithshëm, gjë që, në mënyrë indirekte, buxhetin e gjyqësorit e vuri në varësi të një pushteti tjetër. Duhet thënë hapur kjo gjë: pushtetit ekzekutiv", u shpreh avokati, Sokol Hazizaj.

"Sepse drejtori në Kryeministri është një funksion që sot është, nesër nuk është dhe, në fakt, sot nuk ka drejtor Kryeministria...", shtoi Hazizaj.

Unioni i Gjyqtarëve e kundërshtoi ndryshimin. Me vendimin nr. 35, të vitit 2022, Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi, duke vlerësuar se formula e re ulte pagën referuese dhe pagën bruto, në kundërshtim me nenin 138 të kushtetutës. Ligjvënisi mund ta ndryshonte mekanizmin, por jo ta përdorte për uljen e pagës. Vendimi hyri në fuqi më 9 janar 2023.

Ligji nr. 33 I vitit 2023 lidhi bazën, me pagën e Presidentit, me koeficientin 0.36. Nga paga presidenciale 425 000 lekë rezultoi bazë 153 000 lekë, vetëm 570 lekë më shumë se më parë, por, u ndërpre lidhja me rritjen e pagave në administratë.

"Diskutimi ka qenë se sa do të jetë koeficienti i referencës te Presidenti, do të jetë 0.48 apo 0.46. Gjykata Kushtetuese e gjeti 0.48 të gabuar, tani duhet të shkojmë te 0.46.

Po kjo nuk do të thotë që do të shkojë me përmbarim pushteti gjyqësor, i cili ka kompetenca. Ia ka dhënë ligji kompetencat për të bërë vendime pezullimi, për të bërë ndjekje penale dhe ia ka dhënë për të zgjidhur hallet e njerëzve, jo për të zgjidhur hallet e veta", u shpreh Ylli Manjani.

Ndërsa pagat e administratës dhe ajo e Presidentit u rritën, baza e magjistratëve mbeti 153 000 lekë. Sipas Unionit, formula e vitit 2016 do ta çonte në 231 000 lekë. Ligji i vitit 2023 nuk e uli shumën nominale, por, pengoi rritjen që do të sillte mekanizmi i mëparshëm. Kushtetuesja dhe magjistratët në tërësi e cilësuan këtë "ulje të fshehur". Magjistratët pretenduan se ruajtja e vlerës reale të pagës varej tashmë nga vendimi periodik i ekzekutivit.

I Kryesore



"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh"/ Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë

18:25

"Kontakte telefonike si bashkëpunëtor i shërbimit", zbardhet dëshmia e Vlora Hysenit për lidhjet me Ergys Agasin tre ditë para arrestit

15:11

Një vit krim në seri në Sarandë/ Ministri i Brendshëm kërkoi shkrirjen e zinxhirit komandues, Feliks Hoda largohet nga drejtimi i komisariatit, ja kush e zëvendëson

16:21

El Niño i fuqishëm mund të shkaktojë 451 mijë vdekje nga nxehtësia në gjashtë muaj, cilat vende janë më të rrezikuara

16:21

I akuzuar për përdhunim tre vite më parë, ylli i PSG-së del përpara gjykatës

17:16

I Më të lexuarat

Kryeministri Rama komandon drejtuesin e ri të SHISH pas shkarkimit të Vlora Hysenit

"Pinte kafe çdo javë me ish-kreun e SPAK te zyra e tij"/ Urdhër-arresti ndaj Vlora Hysenit, gazetari Qyno në 'Top Story': Dumani hetoi edhe Fatos Klosin, por ai mori pafajësinë

"Bela me Taon janë shokë, do bëhët kryetar Kuvendi", zbardhen SMS-të mes Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit në dosjen e SPAK

"Kontakte telefonike si bashkëpunëtor i shërbimit", zbardhet dëshmia e Vlora Hysenit për lidhjet me Ergys Agasin tre ditë para arrestit

"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh"/ Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë

"Tao kryetar Kuvendi, Skënderi më thirrri me u taku"/ Mesazhet e Vlora Hysenit me Ergys Agasin zbulojnë klanin e Belinda Ballukut në PS dhe Polici

36-vjeçari shqiptar u vra në Itali teksa po vidhte, flet bashkëshortja: Djali im nuk ka më baba dhe unë jam e shkatërruar

Dokumenti/ Emri i Vlora Hysenit në dekreten

"Mënyra se si ndryshoi konceptualisht marrëdhënia financiare e gjyqtarit, nga një pushtet me buxhet të pavarur në një buxhet tërësisht të varur nga ekzekutivi, prishi balancat, raportet, kushtet, pra sot çdo lloj diskutimi që bëhet është bosh, çdo gjë fillon këtu", u shpreh avokati Sokol Hazizaj.

"Dhe Venecia thotë që referimi duhet të jetë te zyrtarët e lartë të shtetit, jo te zyrtarët e ulët. Në 2016-n, referenca e gjyqtarit ishte një drejtor në Kryeministri; në 2023-shin u bë referenca te zyrtari i lartë i shtetit, Presidenti i Republikës, siç thotë Venecia", u shpreh Ylli Manjani.

Më 20 mars 2025, Unioni i Gjyqtarëve iu drejtua sërish Kushtetueses. Ata pretenduan se në vlera absolute, pagat e tyre u ulën pasi rrogat e funksioneve të tjerë publikë u rritën. Kuvendi dhe qeveria argumentuan se baza prej 153 000 lekësh ishte pak më e lartë se ajo e mëparshme dhe se indeksimi dyvjeçar e mbronte nga zhvlerësimi.

"Por cinizmi është ky: për pagat e tyre shkojnë menjëherë dhe i referohen vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa për hallet e njerëzve nuk e njohin Gjykatën Kushtetuese. E kanë injoruar edhe për mënyrën e marrjes së provave digjitale, që është një risi në jurisprudencën tonë, të cilën GJK-ja e ka futur me shumë kurajë. E injorojnë. Po të gjetën një memorie celulare, të grijnë ty dhe të gjithë ata me të cilët ke bashkëbiseduar ndër vite. GJK-ja e ndaloj këtë gjë, ndërsa ata vazhdojnë ta injorojnë...", thotë Manjani.

Me vendimin nr. 15/2026, Kushtetuesja i dha pjesërisht të drejtë Unionit: neni 138 mbron jo vetëm shumën nominale, por edhe vlerën reale, objektivitetin dhe qëndrueshmërinë e pagës.

"Ata i referohen vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Dakord, por vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që të bëhet i zbatueshëm, duhet të ketë një ligj. Nuk ka një zyrë përbarimi që nxjerr kërbacin dhe thotë: "Ky është vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe hajde t'i biem". Nuk funksionon kështu. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë e dinë shumë mirë këtë gjë", u shpreh avokati.

"Por edhe ata janë pragmatistë në konceptin e tyre, sepse, në fund të fundit, po ta shikoni, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese ose kthehen në vendin e tyre të punës së mëparshme, ose është detyrim ligjor që të shkojnë në një prej gjykatave në Republikën e Shqipërisë. S'ka asnjë gjë të keqe, madje duhet të jenë fare të qartë që e bëjnë edhe për vete", u shpreh Sokol Hazizaj.

Përllogaritja aktuale nis nga baza 156.825 lekë. Me shtesat ligjore 90% për grupin e parë, 98% për grupin e dytë dhe 106% për grupin e 3-të. Paga pa vjetërsi apo vështirësi arrin rreth 298 mijë, 311 mijë dhe 323 mijë lekë bruto për 3 nivelet. Organet e drejtësisë kërkojnë referencën 236.425 lekë, të përbërë nga 222.425 lekë pagë për pozicionin dhe 14 mijë lekë shtesë për grupin. Gjykata shfuqizoi formulën me koeficientin 0.36 të pagës së Presidentit. Formulën ia la Kuvendit ndërsa efektet financiare duhej të llogariteshin nga 1 prilli 2023.

"Ky është objektivi apo propozimi, sepse pagat aktuale arrijnë në nivele që paga e një gjyqtari të shkallës së parë arrin në 336 mijë lekë në muaj, paga e gjyqtarit të shkallës së dytë është 360 mijë lekë në muaj dhe ata që janë në nivele të larta drejtuese, që përfshijnë organet drejtuese të gjyqësorit, arrijnë në 560 mijë lekë në muaj. Rritja që kërkojnë ka të bëjë me 50% më shumë sesa marrin aktualisht", thotë Genc Gjokutaj.

Me referencën që kërkojnë magjistratët, kjo është tabela e pagave të reja që ato pretendojnë, që për grupin e 3-të arrijnë 487 mijë lekë ose rreth 5 mijë euro. Me vendimin e njëanshëm, duke paraqitur listapagesat e reja në thesar, ata thonë se po zbatojnë formulën e vjetër të rikthyer nga Kushtetuesja, por, praktikisht pagat e tyre pësojnë rritje të konsiderueshme në vlerë.

trancez për urrenir komoetar te merites, isn kreu i SHISH mes të huajve të propozuar për gradën "Klorës"

"SPAK u nxitua me arrestin", ekspert i sigurisë, Xhavit Shala: Prokuroria e Posaçme duhej të vepronte ndryshe me kreun e SHISH, ndoshta me dorëheqje

"E ke dëgjuar atë këngën Zegjine, Zegjine..."/ Aktivistja i zë pritë deputetes së PS në zyrat e Kuvendit. Çausi: Sa të paguajnë?

Top Channel

I Inside Story »



Inside Story/ Magjistratët caktuan pagat e tyre, ish-ministri: Revoltë sindikaliste dhe banditizëm legal

23/09 21:21



Reforma në drejtësi, Inside Story heton bilancin e dekadës: Paga në debat, qytetarët presin drejtësi

23/09 15:28



Inside Story/ Video ekskluzive nga momentet e tmerrit, kamioni zë poshtë kalimtarin në rrugë, shoferi largohet dhe...

16/09 22:27



/ Exclusive në Inside Story, doli nga dasma dhe.../ Nëna e të riut lituanes kërkon të vërtetat e aksidentit misterioz

16/09 21:59



Inside Story/ Momentet shokuese, polici i bën shenjë të ndalojë, shoferi merr përpara çiklistin te vijat e bardha

16/09 21:47




Inside Story/ Një aksident, dy ekspertiza që rrëzojnë njëra tjetrën: Dosja e rëndë që zbulon skemat korruptive!

16/09 21:31

Na ndiqni:



I Video »



Tmerr në Durrës/ Zjari në Lalëz, dalin detajet e reja



Top News- "Pa largimin e Ramës Shqipëria vetëm do rrokulliset", Berisha kërkon bashkim



Top News- Berisha: Të shfrytëzojmë çdo mundësi, t'i japim goditjen Ramës



Top News- Berisha mesazh demokratëve: Të ngrihemi më këmbë, përballje me regjimin



Top News-Për çfarë zyre e ka fjalën Berisha? Zbulon dhuratën e Vlora Hysenit me pajisje inteligjente



Top News- "Siguria kombëtare në duart e krimin", Berisha: Edi Rama një padrino i vërtetë

Lajme

Bota

Sport

Pop News

Programe

Top Channel

Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Kontakt
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Bileta – Portokalli
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.